

RREGULLORE
E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT
“PËR PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTIT MANUAL”

Miraturar me vendimin nr. 8, datë 29.03.2018 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2019 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 20.12.2019 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 25.01.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 75, datë 29.08.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

(e përditësuar)

Në mbështetje të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 13 shkronja “d”, 15 pika 1 dhe 2, dhe 69 pika 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, Mbledhja e Gjyqtarëve

VENDOSI:

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurën e shortit manual:

- a) për caktimin e trupit gjykues për çdo çështje;
- b) për caktimin e kryesuesit dhe relatorit për çdo trup gjykues;
- c) për caktimin e trupit gjykues që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes;
- ç) për caktimin e gjyqtarit që zëvendëson gjyqtarin e përjashtuar.

Neni 2

Parimet

Kjo rregullore bazohet në parimin e transparencës, barazisë së ngarkesës midis gjyqtarëve dhe objektivitetit.

Neni 3

Organizimi i shortit

Ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2019 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 20.12.2019 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 25.01.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

Ndryshuar me vendimin nr. 75, datë 29.08.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

1. Procedura e hedhjes së shortit realizohet në prani të të gjithë gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (Kolegji).
2. Kryetari i Kolegjit drejton shortin në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore, me ndihmën e Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
3. Gjyqtarët e Kolegjit informohen me *e-mail* nga Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun për çështjet e regjistruara në regjistër me numrin përkatës. Gjyqtarët informohen në fillim të çdo shorti për:
 - a) ngarkesën e çështjeve në shqyrtim, nga ku rezulton roli i secilit gjyqtar (si anëtar i trupit gjykues, si kryesues ose si relator);
 - b) numrin e çështjeve që i janë caktuar me short secilit gjyqtar në rolin e relatorit, nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj.
- 3/1. Gjyqtari zëvendësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit merr pjesë në shortin e parë me ngarkesën e çështjeve në shqyrtim (si anëtar i trupit gjykues, si kryesues ose si relator), e cila është e barabartë me numrin më të vogël të çështjeve që kanë në momentin e shortit, gjyqtarët e tjerë të Kolegjit si anëtarë, kryesues dhe si relatorë.
- 3/2. Gjyqtari zëvendësues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit merr pjesë në shortin e parë me numrin e çështjeve të caktuara me short secilit gjyqtar në rolin e relatorit nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj, i cili është i barabartë me numrin e çështjeve më të vogël që kanë në momentin e shortit, gjyqtarët e Kolegjit në rolin e relatorit nga fillimi i procesit të rivlerësimit.
- 3/3. Ngarkesa për gjyqtarin zëvendësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas pikave 3/1 dhe 3/2 të këtij neni, do të përditësohet sipas rezultateve të çdo shorti.
- 3/4. Në rast se nga zbatimi i pikave 3/1 dhe 3/2 të këtij neni, konstatohet se gjyqtari për të cilin ato janë aplikuar, krijon disbalancë të ngarkesës si relator me gjyqtarët e tjerë të Kolegjit, me më pak se gjysmën e ngarkesës së gjyqtarit me numrin më të vogël të çështjeve në cilësinë e relatorit, balancohet ngarkesa e çështjeve nëpërmjet zhvillimit të një procedure shorti për ndryshimin e rolit të relatorit në disa çështje, pa ndryshuar përbërjen e anëtarëve të trupit gjykues, sipas rregullave të mëposhtme.
- 3/5. Numri i çështjeve për të cilat gjyqtari me ngarkesën më të vogël si relator, do të marrë rolin e relatorit të caktuar me short gjyqtarëve të tjerë, duhet të jetë i barabartë për çdo gjyqtar të Kolegjit, duke synuar rritjen e ngarkesës së tij në një numër të përafërt me gjyqtarin me ngarkesën më të vogël në momentin e organizimit të shortit.

- 3/6. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, në bashkëpunim me gjyqtarët e Kolegjit, evidenton për secilin gjyqtar nga 5 (pesë) çështje në rolin e relatorit, me datë më të hershme regjistrimi, për të cilat nuk ka filluar ende përgatitja e tyre, sipas parashikimit të nenit 14, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në të cilat gjyqtari me ngarkesën më të vogël ka rolin e anëtarit të trupit gjykues, por jo atë të kryesuesit.
- 3/7. Të dhënat e çështjeve të evidentuara sipas pikës 3/6 të këtij neni shënohen në 5 (pesë) shirita të barabartë letre, të cilët futen në gogla, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Gjyqtari me ngarkesën më të vogël si relator tërheq në mënyrë rastësore aq gogla sa është numri i çështjeve, sipas rregullit të përcaktuar në pikën 3/5 të këtij neni. Kjo procedurë realizohet për çështjet e çdo gjyqtari që do të zëvendësohet në rolin e relatorit, sipas rendit alfabetik të mbiemrit të tyre.
- 3/8. Në shortin vijues që do të organizohet pas procedurës së balancimit të ngarkesës, numri i çështjeve si relator për gjyqtarin të cilit i është balancuar ngarkesa, nuk do të përcaktohet më sipas parashikimit të pikës 3/1 të këtij neni, por do të jetë numri që rezulton pas balancimit.
4. Shorti organizohet jo më vonë se 10 ditë nga data e regjistrimit të çështjes së depozituar për gjykim. Shorti hidhet për çdo çështje sipas radhës së regjistrimit të çështjes në regjistrin përkatës.
5. Për çdo rast të organizimit të shortit, Kryetari i Kolegjit njofton me shkrim ose me *e-mail* gjyqtarët të paktën 24 orë përpara hedhjes së shortit. Njoftimi përmban numrin e regjistrimit të çështjes që do të hidhet në short, datën, orën, sallën e hedhjes së shortit.

Neni 4 Procedura e shortit

1. Procedura e shortit zhvillohet në mjediset e punës në të cilat zhvillon veprimtarinë Kolegji.
2. Në çdo rast, shorti hidhet në të njëjtën kohë për caktimin e trupit gjykues me 5 (pesë) anëtarë, si dhe për caktimin e gjyqtarit kryesues dhe relator.
3. Në çdo procedurë shorti, çështja identifikohet me numrin rendor që mban në regjistrin e çështjeve.
4. Të gjitha procedurat e shortit, në çdo rast evidentohen në procesverbalin që mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm.

Neni 5 Procedura e shortit për caktimin e trupit gjykues

1. Kolegji gjykon në trupa gjykues të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje.

2. Shorti për caktimin e trupit gjykues organizohet sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Në rast se në momentin e hedhjes së shortit për çdo çështje, rezulton se njëri prej gjyqtarëve ka 3 (tre) ose më shumë çështje në shqyrtim, në raport me gjyqtarët e tjerë, ky gjyqtar nuk merr pjesë në hedhjen e shortit. Në hedhjen e shortit marrin pjesë, në çdo rast, jo më pak se 6 (gjashtë) gjyqtarë. Në rast se në momentin e hedhjes së shortit rezulton se më shumë se një gjyqtar ka 3 (tre) ose më shumë çështje në shqyrtim në raport me gjyqtarët e tjerë, hidhet në short se cili prej tyre nuk do të marrë pjesë në hedhjen e shortit për caktimin e trupit gjykues.
3. Rolet e gjyqtarëve shkruhen në shirita të barabartë letre, me gërmë *Times në roman 14, bold*. Në 5 (pesë) shirita letre shkruhet “**Anëtar**”, kurse në 2 (dy) shirita letre shkruhet “**Gjyqtar pa rol**”. Shiritat e letrës verifikohen për saktësinë nga të gjithë të pranishmit në sallë nëpërmjet ekspozimit nga Kryetari i Kolegjit. Pas verifikimit, Kryetari i palos shiritat në mënyrë të njëjtë dhe i vendos në goglat përkatëse. Goglat, përpara se të hidhen në kutinë transparente, preken me dorë nga gjyqtari që dëshiron, përveç Kryetarit, për të verifikuar njëtrajtshmërinë dhe barazinë e tyre në formë dhe ngrohtësi. Pas këtij verifikimi, Kryetari i vendos goglat në kutinë transparente dhe i përziën, me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
4. Pas përzierjes së goglave, çdo gjyqtar, duke filluar sipas rendit alfabetik të mbiemrit, tërheq në mënyrë rastësore një gogël. Kryetari i Kolegjit përziën goglat pas çdo tërheqje dhe i përgatit për tërheqjen nga gjyqtari i radhës. Për çdo gogël të tërhequr nga gjyqtari, Kryetari i Kolegjit lexon me zë të lartë përmbajtjen e saj.
5. Në përfundim të kësaj procedure, Kryetari i Kolegjit lexon edhe një herë emrat e trupit gjykues.

Neni 6

Procedura e shortit për caktimin e kryesuesit dhe relatorit

Ndryshuar me vendimin nr. 28, datë 20.12.2019 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

1. Kryesuesi i trupit gjykues dhe relatori i çështjes caktohen me short, pasi është përzgjedhur trupi gjykues.
2. Fillimisht hidhet shorti për caktimin e gjyqtarit kryesues dhe më pas shorti për caktimin e gjyqtarit relator.
3. Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit kryesues, marrin pjesë gjyqtarët e këtij trupi që kanë më pak çështje në shqyrtim në numër të barabartë mes tyre si kryesues. Në rast se rezulton se vetëm një gjyqtar ka më pak çështje për shqyrtim si kryesues në raport me gjyqtarët e tjerë, ai do të jetë kryesuesi i trupit gjykues.
4. Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit relator marrin pjesë gjyqtarët e këtij trupi gjykues që kanë më pak çështje në shqyrtim në numër të barabartë mes tyre si relatorë. Në rast se rezulton se vetëm një gjyqtar ka më pak çështje për shqyrtim si relator, në raport me gjyqtarët e tjerë, ai do të jetë relator i çështjes. Në këtë short nuk merr pjesë gjyqtari i caktuar si kryesues i këtij trupi.

- 4/1. Në hedhjen e shortit për caktimin e gjyqtarit relator, përjashtohen nga shorti ata gjyqtarë të cilët, në raport me gjyqtarët e tjerë të Kolegjit, kanë më shumë se tri (3) çështje të caktuara me short në rolin e relatorit, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit në Kolegj. Në rastet kur gjyqtarët të cilët do të shortohen për t'u përzgjedhur në rolin e relatorit, kanë, që nga fillimi i procesit të rivlerësimit, më shumë se tri (3) çështje ngarkesë nga gjyqtarët e tjerë, shorti për përzgjedhjen e relatorit do të hidhet mes gjyqtarëve që kanë ngarkesë numër më të vogël ose të barabartë çështjesh.
5. Procedura zhvillohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Sipas rastit, në 1 (një) shirit letre shkruhet "**Kryesues**", në 1 (një) shirit tjetër letre shkruhet "**Relator**", kurse në shiritat e tjerë shkruhet "**Anëtar**".
6. Në përfundim të gjithë kësaj procedure, Kryetari i Kolegjit lexon edhe një herë emrat e gjyqtarëve sipas rolit brenda trupit gjykues.

Neni 7

Procedura e hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes

1. Në rast se gjyqtari i Kolegjit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkak se gjendet në kushtet e nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përjashtimi i tij vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short, i cili hidhet brenda së njëjtës ditë kur paraqitet kërkesa për heqje dorë.
2. Shorti për caktimin e trupit gjykues, sipas pikës 1 të këtij neni, organizohet sipas përcaktimeve të nenit 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje. Emri i gjyqtarit që ka kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes hiqet nga procedura e shortit.
3. Procedura e hedhjes së shortit është e njëjtë me atë të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
4. Kryesuesi i këtij trupi gjykues zgjidhet me short midis anëtarëve, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 8

Procedura e hedhjes së shortit për caktimin e gjyqtarit që zëvendëson gjyqtarin e përjashtuar

1. Gjyqtari që është përjashtuar zëvendësohet nga një gjyqtar tjetër i caktuar me short.
2. Shorti për caktimin e gjyqtarit, sipas pikës 1 të këtij neni, organizohet sipas përcaktimeve të neneve 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje.
3. Në këtë short marrin pjesë gjyqtarët që nuk janë pjesë e trupit gjykues. Procedura zhvillohet sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj rregulloreje. Në secilin nga shiritat e letrës shkruhet "**Anëtar**" dhe "**Gjyqtar pa rol**".

4. Në përfundim të kësaj procedure, Kryetari i Kolegjit lexon edhe një herë emrin e gjyqtarit që zëvendëson gjyqtarin e përjashtuar.

Neni 9 Delegimi

1. Gjyqtari, i cili për arsye objektive, në ditën dhe orën e caktuar mungon në hedhjen e shortit, mund të delegojë të drejtën e tërheqjes së shortit, sipas procedurës së delegimit të përcaktuar në nenet 28 dhe 29, pika 1 të “Kodit të procedurave administrative”.
2. Në aktin e delegimit, gjyqtari përcakton këshilltarin e Njësisë së Shërbimit Ligjor që do të ushtrojë kompetencën e deleguar.

Neni 10 Hyrja në fuqi dhe ndryshimi i rregullores

1. Rregullorja hyn në fuqi me miratimin nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
2. Kjo rregullore mund të ndryshohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, veçanërisht, në rast se nga zbatimi i saj do të rezultojë shpërndarje e pabarabartë e ngarkesës midis gjyqtarëve.